



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Për :	Naim Ismajli, Kryetar i Komunës së Shtimes Rahman Jakupi, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Shtimes	
Kopje:	Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njësia për Administrimin e Dokumenteve në Komunë Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave -MAPL	
Përmes:	Mirjana Jevtić, Ministre e MAPL-së Rozafa Ukimeraj, Sekretare e Përgjithshme e MAPL-së	
Nga:	Shkelqim Jakupi, U.D i Udhëheqësit të Departamentit Ligjor dhe Monitorimit të Komunave, MAPL	Datë: 11/04/2017
Lënda:	Konfirmimi i ligjshmërisë së aktit të Kuvendit të Komunës së Shtimes	020-565
Lloji i aktit:	Vendim	

I nderuar Kryetar,
I nderuar Kryesues,

Në pajtim me Rregulloren e QRK-së Nr. 01/2016 për Shqyrtimin administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 02/2011 për Fushat dhe Përgjegjësit Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr.03/L-040 Për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

Vendimi Nr. 01-99, për Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës me Pronat e Paluajtshme Private, me qëllim të zgjerimit të rrugës Muzeqinë-Rashincë.
I miratuar më datë më datë: 31.03.2017
I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 07.04.2017

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të aktit të komunës si me sipër, vlerëson se akti i komunës në aspektin procedural është në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi dhe si i tillë mund të prodhojë efekte juridike. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm në lidhje me këtë vlerësim.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Za :	Naim Ismaili, gradonačelnik opštine Štimlje Rahman Jakupi, predsedavajući Skupštine opštine Štimlje	
Kopija:	Jedinica za administraciju dokumentacije u MALS-u Jedinica za administraciju dokumentacije u opštini Zakonsko odeljenje i monitorisanje opština-MALS	
Preko: ZA. BAJRAM GECAD	Mirjana Jevtić, ministarka MALS-a, Rozafa Ukimeraj, generalna sekretarka u MALS-u	
Od:	Shkëlqim Jakupi, v.d. rukovodioca, zakonskog Odeljeja i monitorisanje opština, MALS	Datum: 11/04/2017 020-565
Predmet:	Potvrda zakonitosti akta Skupštine opštine Štimlje	
Vrsta akta:	Odluka Skupštine opštine	

Poštovani gradonačelnice,
Poštovani predsedavajući

U saglasnosti sa uredbom Vlade Republike Kosova br. 01/2016 za administrativno razmatranje akata opštine i na osnovu zakonskih ovlašćenja određenim osnovnim zakonima i uredbom Vlade br. 02/2011 o poljima odgovornosti administrativne Kancelarije premijera i ministarstva, Odeljenje za zakonska pitanja i monitorisanje opština MALS-a, primilo je za obavezno razmatranje zakonitosti akta opštine kako je predviđeno članom 81. Zakona br.03/L-040 o lokalnoj samoupravi kao u nastavku:

Odluka br. 01-99 za razmenu nepokretne opštinske imovine sa nepokretnim privatnim imovinama, u cilju proširivanja puta u pravcu Muzećine-Rašice
Usvojena dana, 31.03.2017. godine
Predložena na razmatranje u MALS-u dana, 07.04.2017. godine

Ministarstvo administracije lokalne samouprave, nakon razmatranja sadržaja gore navedenog opštinskog akta, procenjuje da je opštinski akt, sa proceduralnog gledišta u skladu sa odredbama zakonodavstva na snazi i kao takav može proizvesti punopravni učinak. Ministarstvo administracije lokalne samouprave stoji na raspolaganju opštini za bilo kakvo dodatno objašnjenje u vezi sa ovom procenom.



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS-SHTIME
Nr.01-60/01-7956/17 datë:20.03.2017



Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministry of Local Government Administration
Date: 07.04.2017
-17-00-565

Npi - 01/99 datë: 31.03.2017

Duke u bazuar në nenin 12.2 pikë (d) dhe 29 të Ligjit mbi Vetqeverisjen Lokale nr 05/L-040 ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr 28/2008); Nenit 11 të Ligjit Nr.04/L-144 për dhënjen në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme të Komunës. Kuvendi i Komunës së Shtimes, shqyrtoi kërkesën e Kryetarit të Komunës Nr.02/126, datës: 30.03.2017, me të cilën i ka propozuar Kuvendit që të merr Vendim për këmbimin e pronës së paluajtshme (Ngastra e cila ofrohet për këmbim) Ngastra Kadastrale Nr. P-00764-0, me sipërfaqe prej 90 m², Z.K.-Muzeqinë e cila evidentohet Pasuri Shoqërore e Rrugëve. Me pjesë e Ngastrave Kadastrale Nr.P-00762-0, P-00763-0, P-00765-0, të cilat evidentohen në emër të Daut (Bajram) Bajrami nga Muzeqina, si dhe pjesë nga Ngastra Kadastrale Nr.P-00840-0 e cila evidentohet në emër të Hajrë (Bajram) Bajrami nga Muzeqina, Z.K.- Muzeqinë. Ndërrimi i pronave propozohet të bëhet në proporcion të barabartë 1/1 (metër për metër), me arsyetim se pronat të cilat janë objekt këmbimi janë të barazvlershme, dhe gjenden në afërsi njëra me tjetrën. Kuvendi i Komunës duke marrë për bazë propozimin e Kryetarit si dhe Rekomandimet e Komiteti për Politikë dhe Financa, në mbledhjen e mbajtur më 31.03.2017, miratoi këtë:

V E N D I M

PËR KËMBIMIN E PRONËS

I

Kuvendi i Komunës së Shtimes në mbledhjen e tretë të rregullt për vitin 2017, të mbajtur më datën: 31.03.2017, me shumicën e votave aprovoi vendimin për këmbimin e pronës së paluajtshme (Ngastra e cila ofrohet për këmbim) Ngastra Kadastrale Nr. P-00764-0, me sipërfaqe prej 90m², Z.K.-Muzeqinë e cila evidentohet Pasuri Shoqërore e Rrugëve. Me pjesë nga ngastrat me të cilat bëhet ndërrimi janë si vijon: Pjesët e Ngastrave Kadastrale Nr.P-00762-0, P-00763-0, P-00765-0, të cilat evidentohen në emër të Daut (Bajram) Bajrami nga Muzeqina, si dhe pjesë nga Ngastra Kadastrale Nr.P-00840-0 e cila evidentohet në emër të Hajrë (Bajram) Bajrami nga Muzeqina, me sipërfaqe prej 90m², Z.K.- Muzeqinë. Ndërrimi i pronave propozohet të bëhet në proporcion të barabartë 1/1 (metër për metër), me arsyetim se pronat të cilat janë objekt këmbimi janë të barazvlershme, dhe gjenden në afërsi njëra me tjetrën.

II

A r s y e t i m: Në bazë të nenit 11 të Ligjit, Nr. 04/L-144 për dhënjen në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme të komunës, ku thuhet se Komuna ka të drejtë të këmbjë pronë e paluajtshme komunale me persona fizik dhe juridik në rastet kur një këmbim i tillë nevojitet për qëllime të shfrytëzimit për interes publik. Kryetari i Komunës i propozon Kuvendit aprovimin e vendimit për ndërrimin e paluajtshmërive me persona fizik, me qëllim të zgjerimit të rrugës Muzeqinë-Rashinë. Drejtoria për Planifikim Urban, Kadastër dhe Gjeodezi, ka evidentuar pronat e paluajtshme, dhe duke shqyrtuar gjendjen faktike konstaton se Ngastra kadastrale me Nr. P-00764-0, Z.K. - Muzeqinë e cila evidentohet si Pasuri Shoqërore e Rrugëve (ngastra e cila ofrohet për këmbim) është pronë e cila fillon dhe mbaron nëpër pronë private të familjes Bajrami andaj nuk e kryen funksionin për të cilën është destinuar si rrugë, (rrugë qorre). Prandaj propozohet që të ndërrohen, pjesët nga Ngastrat Kadastarale me numër: P-00762-0; P-00763-0; P-00765-0 të evidentuara në emër të Daut (Bajram) Bajrami nga Muzeqina, si dhe Ngastra Kadastrale me numër: P-00840-0 e cila evidentohet në emër të Hajrë (Bajram) Bajrami nga Muzeqina, që të ndërrohen me Ngastrën Kadastrale me numër: P-00843-0; Z.K.-Muzeqinë e cila evidentohet Pasuri Shoqërore e Rrugëve (pjesa e rrugës Muzeqinë - Rashinë, ana e djathtë).

III

Vendimi u dërgohet: Arkivit, Palëve, Drejtorisë, Kryetarit të Komunës, Zyrës për Informim, dhe Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal.



Kryesuesi i Kuvendit
Rrahman Jakupi